

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 95, datë 13. 2. 2003

PËR KRIJIMIN NË QARQE TË DREJTORIVE RAJONALE TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT

Në mbështetje të neneve 95 e 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e 12 drejtorive rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit (DRBU), në bazë të ndarjes së sotme territoriale në qarqe të Republikës së Shqipërisë, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit;
 2. Strukturat dhe organikat e këtyre drejtorive rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit miratohen me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 4. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Vendimi nr.425, datë 28.9.1992, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e drejtorive të bujqësisë dhe të ushqimit në rrethe", shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

MINISTRI I BUJQËSISË DHE I USHQIMIT
AGRON DUKA